



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 10/2021 regjistri (JD)
Datë. 01.11.2021

Nr. 3 i vendimit
Datë 25.01.2022

VENDIM
PËR MOSKALIMIN E ÇËSHTJES
PËR SHQYRTIM NË SEANCË PLENARE

Kolegji i Shqyrtimit Paraparak, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Gjyqtar
Rezarta Schuetz	Gjyqtare
Ardian Hajdari	Gjyqtar

- mori në shqyrtim paraparak në dhomë këshillimi, më datë 25.01.2022, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 10/2021, datë 01.11.2021, që i përket:

KËRKUES : Hasan Roqi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese: Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Altin Binaj, Përparim Kalo, Sonila Bejtja, Elsa Toska

OBJEKTI:

- Marrjen e masave disiplinore, civile, penale, administrative, nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në respekt të nenit 128 pika 1; pika 2 shkronja a); pika 3 shkronja c); të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ndaj shkeljes së rëndë nga anëtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë në dhënien e vendimeve nr.86, datë 22 qershor 2021; nr.86/1 datë 28 Shtator 2021 dhe vendimi nr.111, datë 28 shtator 2021 të Gjykatës Kushtetuese;
- Shpallja antikushtetuese e vendimit nr.86, datë 22 qershor 2021; vendimit nr.111, datë 28 shtator 2021 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë;
- Gjykimi i drejtë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në përputhje me kërkesat e Kushtetutës së Republikës së

Shqipërisë, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe ligjit për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, të gjashtë kërkesave të parashtruara nga kërkuesi më datë 25 Mars 2021, para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë sipas subjekteve të interesuara, objektit ku përfshihet shpërblimi i dëmit dhe bazës ligjore shoqëruar me dokumentacionin provues përkatës të saj;

- Të gjendur para një vendimi, që përkrah veprimet e paligjshme, drejtësinë e korruptuar në një shtet të kapur dhe, në mënyrën më arbitrare duke shkelur hapur Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenet 6.1; 8; 13; 14; 41 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, ku Autoriteti i Lartë Kontraktual shqiptar si pjesë e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka krijuar zhgënjim, dëshpërim dhe sjellë në gjendje të rëndë shoku, viktimat e familjes Roqi, banesa e të cilëve u grabit me dhunë kriminale shtetërore, në shkelje të vendimit 76/2000 të Gjykatës Kushtetuese dhe ligjit të veçantë. Të gjendur para diskriminimit publik, ripersekucionit politik, shkeljes së barazisë para ligjit, veçimit social e shoqëror të përkrahura këto veprime nga vendimi nr. 86, datë 22 qershor 2021 dhe nr. 111, datë 28 shtator 2021 i Gjykatës Kushtetuese kërkojmë:

shpërblimin e dëmit psiko-moral në shumën e 5 pagave mujore nga secili nga antarët e Gjykatës Kushtetuese, për llogari të viktimave të familjes Roqi;

- Në kushtet kur Gjykata Kushtetuese ka marrë mbi vete për herë të dytë, përgjegjësinë e shkeljes flagrante të nenit 6.1; nenit 8; nenit 13; nenit 14; nenit 41, Konventa Evropiane e të Drejtave Njeriut, kërkoj që dëmi moral e material prej 118 muaj nga nxjerrja me dhunë kriminale shtetërore nga banesa, pagesa për privatizimin e një banese në kushte të barabarta me anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, qeveritarët dhe parlamentarët, pagesa për vonesën e qëllimshme të ekzekutimit të vendimit 76/2000 të Gjykatës Kushtetuese, të bëhet nga xhepat e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe jo nga taksapaguesit shqiptarë;

- Marrja e masave të sigurisë për ruajtjen e jetës së viktimave të familjes Roqi, H. Roqi, L. Roqi, S. Roqi, K. Roqi nga shkelësit e Kushtetutës së RSH, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE:

- Neni 6.1, neni 8, neni 13, neni 14, neni 41 Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Neni 44, neni 128 pika 1, pika 2 shkronja a), pika 3 shkronja c), neni 179 pika 7 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Neni 1 pika 2, neni 10 pika 6, pika 13, neni 10/a neni 10/b pika 1 shkronjat b),ç),d) neni 16, neni 31 pika 1, neni 39 pika 1, shkronjat a),b),ç),d) neni 48 pika 1, neni 49 pika 3 shkronja e) pika 4, neni 50 pika 4, neni 51 pika 1 shkronjat a),b), neni 54 pika 4, neni 56 pika 1,2, neni 71/a pika 1 gërmat a, b, c, ç, neni 72 pika 7, neni 76 pika 1, neni 80 pika 1, neni 81 pika 1,2,3,4, neni 86 pika 1 të Ligjit Nr.8577, datë 10.02.2000 “Për Organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Kolegji i Shqyrtimit Paraprak të kërkesës, pasi dëgjoji gjyqtarin relator Sokol Çomo, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. 86, datë 22.06.2021, pas kërkesës së kërkuarit më datë 09.04.2021, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi kërkuar nuk i ka shtuar mjetet efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f" e Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja "a" e ligjit nr. 8577/2000.
2. Me vendimin nr. 86/1, datë 28.09.2021, me objekt “Ndreqje gabimi të vendimit nr. 86, datë 22.06.2021” Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka vendosur: “Ndreqjen e gabimit material në pjesën hyrëse të vendimit nr. 86, datë 22.06.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve, duke hequr fjalët “Kryesuese e Mbledhjes”, ndërsa me vendimin nr. 111, datë 28.09.2021, me objekt “Saktësimi dhe plotësimi i vendimit nr. 86, datë 22.06.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese”, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.
3. Pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është administruar kërkesa e paraqitur nga z. H. Roqi me nr. prot., {***}, datë 21.10.2021, me objekt dhe bazë ligjore si ajo e përcaktuar në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Me shkresën nr. {***} prot, datë 26.10.2021 me lëndë “Kërkesë për plotësim dokumentacioni”, Kolegji i Posaçëm i Apelimit i ka kërkuar z. Hasan Roqi plotësimin e kërkesës në përputhje me nenin 27, pika 2, germa “e” e ligjit nr 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.
4. Kërkuar ka depozituar kërkesën e protokolluar në Kolegji me nr. {***} prot datë 01.11.2021, me plotësimet e kërkuara duke dorëzuar kopje të vërtetuar të vendimit nr. 86, datë 22.06.2021, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, si dhe kopje të vërtetuar të vendimit nr.76, datë 08.11.2000, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, kërkesë kjo e

regjistruar në regjistrin e çështjeve të Juridiksionit Disiplinor me (JD) nr. 10/2021, datë 01.11.2021.

5. Në nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, parashikohet se *kërkesa shqyrtohet paraprakisht nga kolegji, i përbërë nga tre gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, ku bën pjesë dhe relatori*. Kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Hasan Roqi është shortuar pranë këtij Kolegji më datë 08.11.2021, ku është caktuar dhe trupa gjyqësore për shqyrtimin paraprak.

II. Pretendimet e kërkuesit

6. Kërkuesi i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duke kërkuar:

6.1. Marrjen e masave disiplinore, civile, penale, administrative, nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në respekt të nenit 128, pika 1, pika 2, shkronja “a”, pika 3, shkronja “c” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ndaj shkeljes së rëndë nga anëtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë në dhënien e vendimeve nr. 86, datë 22 qershor 2021; nr. 86/1 datë 28 shtator 2021 dhe vendimit nr.111, datë 28 shtator 2021 të Gjykatës Kushtetuese, pasi, sipas kërkuesit, gjykata e kishte detyrim ligjor të shkruante në vendimin e saj objektin, ashtu siç e kërkonte kërkuesi, pa bërë heqje apo ndryshime, duke e çuar vendimin e kësaj gjykate në tjetër drejtim, duke vënë në dyshim të arsyeshëm dhe si përfundim faktik, dhënien e drejtësisë kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese.

6.2. Shpallja antikushtetuese e vendimit nr. 86, datë 22 qershor 2021; vendimit nr.111, datë 28 shtator 2021 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, duke pretenduar se janë dhunuar të drejtat e tij për t’u dëgjuar e gjykuar sipas kërkesës së tij pasi nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të vendosë para kërkuesit detyrimin se me cilin objekt duhet ta gjykojë çështjen, pasi vetë neni 48, pika 1, “Kufijtë e shqyrtimit të kërkesës”, citon: *“Kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të”*.

6.3. Gjykimin e drejtë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit të gjashtë kërkesave të parashtruara nga kërkuesi më datë 25 mars 2021, para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë për shfuqizimin e disa vendimeve të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe për dhënien e ndihmës juridike parësore, për mbështetjen e Gjykatës Kushtetuese ndaj kallëzimeve të tij, për detyrimin e Gjykatës Kushtetuese të ekzekutojë vendimin e saj nr. 76/2000, për privatizimin e një banese në emër të kërkuesit, si dhe për mbrojtjen e jetës së kërkuesit dhe familjarëve të tij sipas subjekteve të interesuara, objektit ku përfshihet shpërblimi i dëmit dhe bazës ligjore shoqëruar me dokumentacionin provues përkatës të saj.

6.4. Shpërblimin e dëmit psiko-moral në shumën e 5 pagave mujore nga secili nga anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, për llogari të viktimave të familjes Roqi.

6.5. Marrja e masave të sigurisë për ruajtjen e jetës së viktimave të familjes Roqi, H. Roqi, L. Roqi, S. Roqi, K. Roqi nga shkelësit e Kushtetutës së RSH, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese.

6.6. Lidhur me vendimin nr.111, datë 28.09.2021, kërkuksi pretendon se Gjykata Kushtetuese ka vendosur moskalimin e çështjes në seancë plenare duke përsëritur të njëjtin gabim, duke vendosur si datë të kërkesës së tij datën 09.04.2021.

6.7. Kërkuksi pretendon se anëtarët e Gjykatës Kushtetuese ndodhen në kushtet e nenit 10/b, pika 2 dhe nenit 10/ç pika 1 shkronja “ç” e ligjit nr. 8577 datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”. Bazuar në bazën ligjore në hyrje të kërkesës së tij, ai kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si hallkë e fundit e shterimit të mjeteve të marrjes së drejtësisë, marrjen në shqyrtim të kërkesave sipas objektit të kërkesës.

III. Vlerësimi i kërkesës nga Kolegji i Shqyrtimit Paraprak

A. Juridiksioni për shqyrtimin e çështjes

7. Juridiksioni dhe kompetenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në kuadër të Juridiksionit Disiplinor, është trajtuar në vendimin nr. 2/2018 (JD), datë 21.06.2018, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të të gjitha ankesave apo kërkesave të paraqitura e të regjistruara në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit në kuadër të Juridiksionit të tij Disiplinor, të parashikuar nga Kushtetuta, do të gjykohej në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” (në vijim “ligji 8577/2000”), për sa i përket natyrës e procedurës së gjykimit, duke e konsideruar atë si një gjykim kushtetues, të ndryshëm për nga natyra me gjykimin që Kolegji i Posaçëm i Apelimit bën në rastet kur ai gjykon sipas juridiksionit të tij rivlerësues, gjykim i cili ka tiparet e një procesi që ndërthur natyrën administrative me elementet kushtetuese.
8. Kolegji për Shqyrtimin Paraprak, në këndvështrim të parashikimeve të nenit 31/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, vlerëson kriteret që çojnë drejt vendimmarrjes për kalimin ose jo të çështjes në seancë plenare.
9. Në nenin 31/a1 të ligjit nr. 8577/2000 janë përcaktuar rregullimet e veçanta të shqyrtimit paraprak të kërkesës, që kanë të bëjnë me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, me legjitimitimin formal të kërkuksit dhe përfaqësuesit, si dhe me respektimin dhe vlerën e vendimmarrjeve të mëparshme të gjykatës.
10. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, pra duhet të plotësohen bashkërisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej kriterëve që kërkesa të mos kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

¹ Neni 31/a parashikon: “[...] 2. Moskalimi i çështjes në seancë plenare vendoset kur: a) kërkimet e paraqitura në kërkesë nuk hyjnë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese; b) kërkesa nuk është paraqitur nga subjekti që legjitimohet; c) kërkesa është paraqitur nga një person i paautorizuar; ç) vërtetohet se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor; d) kërkuksi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, ose legjislacioni në fuqi parashikon mjete efektive në dispozicion; dh) kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese, ose rivendosja në vend e së drejtës së shkelur nuk është e mundur; e) kërkesa është haptazi e pabazuar”.

B. Vlerësim i pretendimeve të kërkuessit

11. Në çështjen konkrete, Kolegji për Shqyrtimin Paraprak çmon të vlerësojë fillimisht nëse kërkesat e kërkuessit hyjnë në kompetencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në kuptim të nenit 31/a, pika 2, shkronja “a” e ligjit nr. 8577/2000.
12. Kolegji për Shqyrtimin Paraprak arrin në konkluzionin se kërkimet e kërkuessit për:
 - 12.1. *Shpalljen antikushtetues të vendimit nr. 86, datë 22 qershor 2021 dhe vendimit nr. 111, datë 28 shtator 2021 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.*
 - 12.2. *Gjykimin e drejtë, nga KPA, në përputhje me kërkesat e Kushtetutës së RSH, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe ligjit për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, të kërkesave të parashtruara nga kërkuessi më datë 25 mars 2021, para Gjykatës Kushtetuese së RSH, sipas subjekteve të interesuara, objektit ku përfshihet shpërblimi i dëmit dhe bazës ligjore shoqëruese me dokumentacionin provues përkatës të saj.*
 - 12.3. *Shpërblimin e dëmit psiko-moral në shumën e 5 pagave mujore nga secili nga anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, për llogari të viktimave të familjes Roqi.*
 - 12.4. *Marrjen e masave të sigurisë për ruajtjen e jetës së viktimave të familjes Roqi, H. Roqi, L. Roqi, S. Roqi, K. Roqi, nga shkelësit e Kushtetutës së RSH, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese.*
- bazuar në nenin 179/7 të Kushtetutës, i cili parashikon se:
 7. *Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë;*
- si dhe në nenin 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se “Kolegji i Apelimit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjislacionit që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, **ka juridiksion të shqyrtojë: a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”**
- nuk janë në kompetencën dhe juridiksionin disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe nuk mund të kalojnë për shqyrtim në seancë plenare, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronja “a” e ligjit nr. 8577/2000.

13. Kolegji për Shqyrtimin Paraprak konstaton se kërkuesi i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe me kërkesën për marrjen e masave disiplinore, penale, civile dhe administrative ndaj anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në dhënien e vendimit nr. 86, datë 22 qershor 2021, vendimit nr. 86/1 datë 28 shtator 2021 dhe vendimit nr. 111, datë 28 shtator 2021 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

13.1. Lidhur me këtë kërkim, së pari, Kolegji për Shqyrtimin Paraprak vlerëson se Kolegji i Posaçëm i Apelit shqyrton çështje të juridiksionit disiplinor, ku përfshihet edhe shqyrtimi i shkeljeve disiplinore të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, sipas parashikimeve të mësipërme kushtetuese dhe ligjore, ndërsa kërkesat për procedime penale, administrative dhe civile të parashtruara nga kërkuesi, nuk përfshihen në juridiksionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit sipas dy dispozitave kushtetuese dhe ligjore të shtjelluara në vijim.

Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese rregullohet në ligjin nr. 8577/2000.

Për periudhën kur Gjykata Kushtetuese funksionon me dy kolegje, sipas parashikimeve të nenit 179, pika 7, dhe nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, juridiksioni disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ushtrohet nga Kolegji i Posaçëm të Apelit.

Juridiksioni disiplinor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit parashikohet në nenin 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se: “Kolegji i Apelit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjislacionit që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, **ka juridiksion të shqyrtojë: a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë**”.

Në ligjin nr. 8577/2000, në nenin 10/a, përcaktohet se procedimi disiplinor zhvillohet i ndarë në tri faza, ku faza e parë është përcaktuar të jetë **fillimi (inicimi) i procedimit**, faza e dytë, **hetimi lidhur me shkeljen disiplinore**, dhe faza e tretë, **shqyrtimi i shkeljes disiplinore**, sipas parashikimeve të mëposhtme.

“1. Kur ka të dhëna të mjaftueshme se një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka kryer shkelje të parashikuara në nenin 128, të Kushtetutës, dhe në nenin 10, të këtij ligji, me kërkesë të Kryetarit ose të çdo gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese, Kryetari, ose gjyqtari më i vjetër në detyrë, kur subjekt i procedimit është Kryetari, merr masat për fillimin e procedimit disiplinor.

2. Procedimi disiplinor fillon menjëherë nga momenti i konstatimit të shkeljes. Procedimi disiplinor pushon nëse gjyqtari jep dorëheqjen. Në këtë rast ai nuk ka të drejtë të emërohet më në funksione publike për një periudhë 15-vjeçare.

3. Dy gjyqtarë të caktuar me short mbledhin fakte, prova dhe të dhëna të tjera lidhur me shkeljen që i atribuohet gjyqtarit dhe brenda 30 ditëve përgatisin relacionin përkatës dhe ia dërgojnë atë për shqyrtim Komisionit Disiplinor.

4. Komisioni Disiplinor përbëhet nga tre gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të caktuar me short, pa pjesëmarrjen e gjyqtarëve që kanë marrë pjesë në mbledhjen e fakteve dhe provave, sipas pikës 3 të këtij neni. Komisioni merr në shqyrtim relacionin e paraqitur dhe vendos dhënien e masës disiplinore, sipas nenit 10/b, të këtij ligji, ose pushimin e çështjes për shkak se nuk provohet shkelja.

5. Gjyqtari, subjekt i procedimit, ka të drejtë të ushtrojë ankim ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor. Ankimi shqyrtohet nga komisioni ad hoc i përbërë nga tre gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, që nuk kanë marrë pjesë në procedim, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij neni”.

Faza e **shqyrtimit të shkeljes disiplinore** rregullohet në mënyrë të posaçme edhe në nenin 10/c të po këtij ligji, të titulluar “Shqyrtimi i shkeljes disiplinore”, me përmbajtje:

1. Komisioni Disiplinor shqyrton çështjen brenda 10 ditëve nga paraqitja e relacionit dhe vendos:

a) dhënien e masës disiplinore;

b) rrëzimin e propozimit për masë disiplinore;

c) kthimin e çështjes për mbledhje të provave dhe fakteve të tjera;

ç) pushimin e çështjes, kur gjyqtari jep dorëheqjen nga detyra ose i mbaron mandati.

2. Vendimi i njoftohet gjyqtarit të proceduar dhe në çdo rast publikohet. Kur ndaj gjyqtarit të proceduar vendoset shkarkimi nga detyra, vendimi i dërgohet organit të emërtesës.

13.2. Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, nga interpretimi në harmoni i nenit 179/7 të Kushtetutës, nenit 5, pika 3, të ligjit 84/2016, dhe i dispozitave të ligjit nr. 8577/2000, të sipërcituara, arrin në konkluzionin se në kompetencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit hyn vetëm faza e tretë e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, ajo e shqyrtimit **të shkeljes disiplinore** e cila kryhet vetëm pas përfundimit të fazës së dytë, atë të hetimit të shkeljes disiplinore. Ky interpretim bazohet edhe në faktin se në shqyrtimin e shkeljeve disiplinore ndaj subjekteve të parashikuara në nenin 179, pika 7 e Kushtetutës, dhe në nenin 5, pika 3 e ligjit 84/2016, fillimi i procedimit dhe hetimi lidhur me shkeljen disiplinore nuk kryhen nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit por nga institucionet përkatëse të ngarkuara me ligj², ndërsa Kolegji në të gjitha këto raste, për këto subjekte, kryen vetëm **shqyrtimin e shkeljes disiplinore** si një “gjykatë disiplinore”.

Gjatë periudhës së parashikuar nga Kushtetuta në nenin 179/b, pika 5, përgjatë të cilës Gjykata Kushtetuese funksionon e ndarë në dy kolegje, referuar dhe sanksionimit të qartë që Kushtetuta i bën juridiksionit specifik për secilin nga dy kolegjet dhe ushtrimin të funksionit kushtetues brenda këtij juridiksioni nga gjyqtarët e këtyre dy kolegjeve, faza procedurale e **fillimit të procedimit disiplinor** dhe faza procedurale e **hetimit të shkeljes disiplinore**, kryhen ekskluzivisht nga kryetari/gjyqtarët e secilit kolegji kundrejt kryetarit/gjyqtarëve të kolegjit përkatës.

Bazuar në këtë interpretim, Kolegji për Shqyrtimin Paraprak vlerëson se kërkuesi Hasan Roqi nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, për ushtrimin e juridiksionit disiplinor ndaj anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, dhe kjo kërkesë e tij nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronja “b” e ligjit nr. 8577/2000.

14. Në përmbledhje të sa më sipër, Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, bazuar në parashikimet e nenit 31, pika 3 e ligjit nr. 8577/2000, si dhe të nenit 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “b” të po këtij ligji, çmon se të gjitha kërkimet e paraqitura nga kërkuesi nuk janë në kompetencën dhe juridiksionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, dhe se ai është një subjekt që nuk legjitimohet për paraqitjen e kërkesës.

15. Kolegji vlerëson që çdo kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese duhet t’u paraqitet subjekteve të përcaktuara në nenin 10/a, pika 1 e ligjit nr.

² Nenet 6, 104 dhe 208 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”

8577/2000. Në rast se kërkesa të ngjashme do të paraqiten në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, ato nuk duhet të regjistrohen si çështje të juridiksionit disiplinor, por duhet të përcillen për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese.

16. Në përfundim, Kolegji për Shqyrtimin Paraprak çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji për Shqyrtimin Paraprak, bazuar në nenin 31, dhe në nenin 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.
2. Përcjelljen e kërkesës së kërkuarit Hasan Roqi Gjykatës Kushtetuese.

Tiranë, më 25.01.2022

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi